

Konferenca Ndërkombëtare

“Zhdukjet me forcë dhe në mënyrë të pavullnetshme në kohën e diktaturës dhe të kaluarës autoritare, si dhe konteksti bashkëkohor: një vlerësim social, ligjor dhe historik i politikave dhe mekanizmave të tranzicionit dhe transformimit”

Fjala e hapjes nga Ambasadori Vincenzo Del Monaco

*13, 14 dhe 15 dhjetor 2021
Vendi: Hotel MAK Albania, Iliria I,
Tiranë*

E kam të qartë se konferenca e sotme zhvillohet në një format hibrid, kështu që kemi ministrin e drejtësisë të lidhur me ne online, ashtu sikurse edhe ambasadorin e Republikës Federale të Gjermanisë dhe pjesëmarrës të tjerë të nderuar.

I nderur ministër, Shkëlqesitë tuaja, i nderuar Rektor i Universitetit të Tiranës, të nderuar folës dhe panelistë, të nderuar pjesëmarrës,

Kam kënaqësinë e madhe t’ju përshëndes sot me rastin e hapjes së kësaj konference ndërkombëtare për çështjen e zhdukjeve dhe personave të zhdukur me forcë.

Duke u mbledhur së bashku dhe duke u angazhuar në veprime të bashkërenduara, e mbështesim shtetin shqiptar dhe shoqërinë shqiptare për trajtimin e duhur të këtij krimi të regjimit komunist.

Pajtimi përmes pranimit dhe rivendosjes përbën komponentin moral të paqes sociale, si këtu ashtu edhe gjetkë. Konferenca e sotme ndërkombëtare mund të shërbejë si një katalizator për veprime të mëtejshme dhe do të doja të shfrytëzoj rastin për të falënderuar donatorin e këtij projekti, të përfaqësuar këtu nga Ambasadori i Gjermanisë, për kontributin financiar shumë bujar. I dashur Peter, kjo konferencë nuk do të ishte e mundur pa mbështetjen tuaj maksimale.

Gjithashtu, dëshiroj të falënderoj edhe një herë bashkë-organizatorin e kësaj konference – Qendrën për Drejtësi dhe Transformim pranë Universiteti të Tiranës, themeluar me mbështetjen e Prezencës për nxitjen e debatit akademik në fushën e drejtësisë tranzitore.

Dhe, sigurisht, edhe ekipin tim, ekipin tim të shkëlqyer, i cili, pavarësisht sfidave të shumta të shkaktuara nga pandemia e COVID-19, arriti të sillte së bashku këtë panel të jashtëzakonshëm, i cili përbëhet prej nesh që jemi të pranishëm këtu në sallë, por edhe prej atyre që janë lidhur online.

Jam shumë i kënaqur që gjendem mes një grupi kaq të larmishëm dhe interesant studiuesish, specialistësh, avokatësh dhe zyrtarësh të nivelit të lartë të mbledhur sot këtu. Dëshiroj ta theksoj vlerën e paçmuar të ekspertizës suaj dhe të shkëmbimit të përvojës, duke qenë i bindur se kërkimi akademik mund të sjellë një këndvështrim të vlefshëm falë qasjes së tij të pashoqe në

gjetjen e së vërtetës: analizës rigoroze, qëndrimit etik dhe vënies në punë të informacionit empirik.

Gjatë tre ditëve të ardhshme, çështja e zhdukjeve me forcë dhe të pavullnetshme do të shqyrtohet nga disa këndvështrime, si ai social, ligjor dhe historik, këndvështrime të cilat pasqyrojnë realitete të ndryshme që shumë shoqëri, brenda dhe jashtë rajonit të OSBE-së, kanë përjetuar gjatë rivendosjes së lirisë dhe shtetit demokratik.

Nëpërmjet diskutimeve interaktive të paneleve dhe prezantimeve të punimeve kërkimore të avancuara nga e mbarë bota, pjesëmarrësit do të kenë mundësinë që ta hulumtojnë dhe rimendojnë çështjen e të zhdukurve nga një këndvështrim ndërdisiplinor, në kontekstet e ndryshme kombëtare.

Kjo sepse trajtimi i duhur i problemit të zhdukjeve me forcë dhe personave të zhdukur nuk është një çështje thjesht administrative. Të gjitha institucionet duhet të luajnë rolin e tyre, së bashku me botën akademike dhe shoqërinë civile, si dhe me partnerët ndërkombëtare, sikurse OSBE-ja, familja e Kombeve të Bashkuara, si dhe mbarë vendet e BE-së.

Zonja dhe zotërinj,
pikërisht në këtë frymë Shqipëria e ratifikoi Konventën Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukjet me Forcë, si dhe traktateve të tjera ndërkombëtare me fuqi ligjore detyruese, duke ndërmarrë detyrimin që të hetojë dhe ndëshkojë krimet dhe shkeljet e të drejtave të njeriut nën regjimin komunist, si dhe që të kërkojë, lokalizojë dhe identifikojë eshtrat e personave të ekzekutuar nga regjimi.

Megjithatë, siç më kanë informuar kolegët, deri më sot nuk është zgjidhur me sukses asnjë rast i vetëm. Drejtësia dhe pajtimi qëndrojnë pezull për të afërmit e rreth gjashtë mijë personave të klasifikuar si të zhdukur për shkak të burgosjeve gjyqësore ose jashtëgjyqësore apo ekzekutimeve të kryera midis viteve 1945 dhe 1991. Faktet tregojnë se të afërmit e të zhdukurve shpesh janë të detyruar që t'i zhvillojnë vetë kërkimet, madje në disa raste janë detyruar që t'i ndërmarrin me forcat e tyre gërmimet e vështira në vende të dyshuara si varreza masive.

Duke bashkëpunuar ngushtë me institucionet shqiptare dhe shoqërinë civile, Prezenca është përfshirë në rritjen e kapaciteteve institucionale, mbështetjen e përpjekjeve legjislative dhe politikëbërëse, si dhe nxitjen e debatit akademik dhe politik lidhur me çështjen e personave të zhdukur në Shqipëri.

Kemi mbështetur themelimin e Qendrës së specializuar për Drejtësinë dhe Transformimin pranë Universitetit të Tiranës, gatishmëria e së cilës për organizmin e kësaj konference meriton fjalët më të mira. Dhe falë themelimit të kësaj Qendre, Prezenca mbështeti një numër të madh studiuesish të rinj shqiptarë, të cilët ndërmorën projekte studimore në fusha të ndryshme të drejtësisë tranzitore.

Muajin e kaluar, së bashku me Universitetin e Tiranës përruam një program akademik, i cili është i pari në llojin e tij, Masterin ndërdisiplinor në Drejtësinë Tranzitore, që synon të nxisë punën studimore dhe ndërgegjësimin e publikut për çështjet sociale, politike dhe ligjore që lidhen me drejtësinë tranzitore.

Kohët e fundit, në funksion të nxitjes së bashkëpunimit shumë të nevojshëm ndërinstitucional për të çuar përpara identifikimin dhe gjetjen e trupave të personave të zhdukur, Prezenca mbajti një seminar teknik. Për herë të parë, të gjitha organet përkatëse kombëtare dhe ndërkombëtare u mblodhën për të diskutuar këtë çështje si dhe nevojën për shtimin e përpjekjeve të tyre bashkërenduese.

Besoj se kjo konferencë do të shërbejë si një platformë për debat të sinqertë dhe të hapur mbi mënyrat se si trajtimi i së kaluarës hap rrugën drejt së ardhmes.

Së fundi, dëshiroj t'u uroj mirëseardhjen time të ngrohtë të afërmve të personave të zhdukur që janë këtu sot për të ndarë përvojën e tyre në zbulimin e së vërtetës për zhdukjen e të dashurve të tyre në ditët vijuese të konferencës.

Jam i bindur se duke dëgjuar dëshmitë tuaja, duke ndjerë dhimbjen dhe përpjekjen tuaj, si dhe duke përfituar realisht nga përvoja dhe ekspertiza juaj, do të mundemi të identifikojmë boshllëqet dhe mundësitë në funksion të zbatimit të zgjidhjeve efektive dhe të qenësishme në praktikë për të lehtësuar dhimbjen, siguruar drejtësi restauruese dhe për të ofruar pajtim.

Asnjë strategji, politikë apo mekanizëm nuk do të ishte efektiv nëse nuk do të pasqyronte përvojën tuaj dhe nuk do të shërbente për të mbrojtur dinjitetin e të afërmve tuaj.

Prandaj, ju falënderoj për pjesëmarrjen tuaj, i shpreh sërish mirënjohjen time ekipit tim, si dhe ju uroj të gjithëve një konferencë sa më përfshirëse dhe të frytshme. Shumë faleminderit!